

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTO RIHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org.Jedinita Org Unit	013
Nr. Prot. Broj Prot:	1893
Nr. I faqeve Br.stranica No. pages	2
Data: Datum:	09,06,2015
Prishtinë / B	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku
i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology**

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Datë: 9 qershor 2015

Ref. 219/013

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (*Gazeta zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010*), duke u bazuar në nenin 8 (1.4) dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011), nenin 92 (c) dhe (d) dhe nenin 93 (93.4) të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative (*Gazeta zyrtare nr. 8, 1 janar 2007*), dhe nenin 9 (9.11) të Kontratës për shërbime të veçanta nr. 2/2896 (20 maj 2014), nxjerr:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Kontrata për shërbime të veçanta nr. 2/2896, e lidhur me 20 maj 2014 ndërmjet MASHT dhe American University in Kosovo Foundation-Prishtinë për realizimin e programit trajnues "Trajnimi i mësimdhënësve për programin - Licenca Evropiane për Njohje të Kompjuterit (European Computer Driving Licence (ECDL))".
2. Pavlefshmëria absolute e kontratës për shërbime të veçanta nr. 2/2896, e shpallur përmes këtij vendimi, ka efekt juridik në kuptim të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative.
3. Udhëzohet American University in Kosovo Foundation-Prishtinë, në përmbushjen e detyrimeve ligjore në fuqi, që lindin si pasojë e pavlefshmërisë absolute të kontratës për shërbime të veçanta nr. 2/2896.

4. Obligohet u.d. Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT që të njoftoj American University in Kosovo Foundation-Prishtinë për vendimin për shfuqizimin e kontratës për shërbime të veçanta nr. 2/2896.
5. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri.

A r s y e t i m

Kontrata për shërbime të veçanta nr. 2/2896, lidhur me datë 20.05.2014 ndërmjet MASHT dhe American University in Kosovo Foundation-Prishtinë për realizimin e programit trajnues "Trajnimi i mësimdhënësve për programin - Licenca Evropiane për Njohje të Kompjuterit (European Computer Driving Licence (ECDL)", përbën shkelje thelbësore të ligjit, me pasojë pavlefshmërinë absolute të tij, meqenëse është lidhur në kundërshtim me procedurën e përcaktuar me ligj, respektivisht, në kundërshtim me kushtet dhe kriteret ligjore të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Konstatimi për shkelje ligjore është konfirmuar edhe nga përgjigjja e pranuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, në shkresën nr. 468/15 të datës 08.06.2015 dhe përgjigjes së pranuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, në shkresën nr. 85/2015 të datës 05.06.2015. Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



Vendimi ju dërgohet:

1. American University in Kosovo Foundation-Prishtinë;
2. u.d. Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
3. Departamentit Ligjor, MASHT;
4. Organit Shqyrtues të Prokurimit;
5. Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
6. Arkivit, MASHT.